



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/40  
Datë: 05.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohen ekstraktet e procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhjet e 37,38 dhe 39 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/40  
Datë: 05.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohen Projektligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/40  
Datë: 05.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L - 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMEVE TË QEVERISË NR. 07/63, TË DATËS 07.05.2009, DHE VENDIMIT NR. 02/48 TË DATËS 24.12.2008.**

1. Ndryshohet dhe plotësohet tabela nën pikën 1. të Vendimit të Qeverisë nr. 07/63, në bazë të cilës përcaktohet niveli maksimal i shpërndarjes së mjeteve financiare dhe numri i përfituesve nëpër ministri, i cili do të jetë si më poshtë:

Nr	Organizata Buxhetore	Shuma (euro)	Numri i përfituesve
1.	Ministria e Financave	225,000 €	14-30
2.	Zyra e Kryeministrit	100,000 €	5-11
3.	Ministria e Drejtësisë	80,000 €	10-20
4.	Ministria e Shëndetësisë	70,000 €	10-20
5.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	70,000 €	10-20
6.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	70,000 €	10-20
7.	Ministria e Infrastrukturës	60,000 €	8-15
8.	Ministria e Integrimit Evropian	40,000 €	7-14
9.	Ministria e Punëve të Brendshme	25,000 €	6-11
10.	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	25,000 €	6-11
11.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	25,000 €	6-11
12.	Ministria e Administrimit të Pushtetit	25,000 €	6-11

	Lokal		
13.	Ministria e Administratës Publike	25,000 €	6-11
14.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	25,000 €	6-11
15.	Ministria e Punëve të Jashtme	25,000 €	6-11
16.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	25,000 €	6-11
17.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	25,000 €	6-11
18.	Ministria e Forcës së Sigurisë	25,000 €	6-11
19.	Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve	25,000 €	6-11
20.	Ministria e Diasporës	10,000 €	3-5
	<b>Total</b>	<b>1,000,000 €</b>	<b>143-276</b>

2. Fshihet në tërësi pika 3 e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/48, të datës 24.12.2008, dhe zëvendësohet si në vijim:  
Kriteret për përzgjedhjen e pozitive, kriteret precize për pagesën e shtesave dhe procedurat e aplikimit zbatohen në bazë të Rregullores së Funkcionimit të Fondit për Kuadro të miratuar nga Komisioni i Fondit për Kuadro të datës 22 shtator 2009 me Nr. Ref. 515/09.
3. Pika 1 e këtij vendimi do të vlejë deri me 31 dhjetor 2011, pas kësaj date ky vendim do të rishikohet për vitin 2012.
4. Obligohen Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/40  
Datë: 05.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14 paragrafi 3. i Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 04/L-001, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për reduktimin e ndarjeve buxhetore në shumë prej 5,000,000 (pesë milion) euro nga:
  - 1.1. 3,000,000 (tre milion) euro, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, programi me kod 001 Pensionet bazike, kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.
  - 1.2. 2,000,000 (dy milion) euro, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, programi me kod 012 Pensionet kontributdhënëse, kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.
2. Mjetet e reduktuara nga pika 1 e këtij vendimi transferohen në:
  - 2.1. 3,000,000 (tre milion) euro, Shpenzimet e paparashikuara (kodi 232-131) në kategorinë ekonomike- Rezerva.
  - 2.2. 2,000,000 (dy milion), Shpenzimet e paparashikuara (kodi 232-131) në kategorinë ekonomike- Shpenzime kapitale.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/40  
Datë: 05.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej € 900,000.00 (nëntëqind mijë) euro për ndërtimin e shtëpive në pjesën veriore në komunën e Mitrovicës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga programi Shpenzimet e paparashikuara, kodi 232-131, kategoria ekonomike - Shpenzime kapitale dhe transferohen në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, programi - Zhvillimi ekonomik, kodi 480 në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Kuvendi Komunal i Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/40

Datë: 05.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim organogrami për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
2. Organogrami nga pika 1. e këtij vendimi zbatohet nga Janari i vitit 2012.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë